

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Mësimi Org.
 Org. Jedinica
 Org. Unit
 Nr. i Faqeve
 Bc. Stranica
 No. Pages

KM-MI-01
 02
 PRISHTINE/A

Nr. i Prot.
 Broj Prot.
 Prot. No.
 Data:
 Datum:
 Date:

586/18
 03/07/18



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Mësimi Org.
 Org. Jedinica
 Org. Unit
 Nr. i Faqeve
 Bc. Stranica
 No. Pages

01
 02
 PRISHTINE/A

Nr. i Prot.
 Broj Prot.
 Prot. No.
 Data:
 Datum:
 Date:

6329
 03.07.18

Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Infrastrukturës
 Ministarstvo Infrastrukture
 Ministry of Infrastructure

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr.82, 21 tetor 2010), Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenit 132, par. 2 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme administrative (gazeta zyrtare nr. 20/21 qershor 2016), nenit 6 të Udhëzimit administrativ nr. 06/2016 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr.09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus, si dhe duke u bazuar në rekomandimin e komisionit profesional nr.4200 datë 08.05.2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa nr. 2756 të datës 28.03.2018 e parashtruar nga Shoqata e Transportuesve të udhëtarëve "Kosova e lirë" "Prizren", Shoqata "Theranda" Suharekë. ndërsa vendimi nr. 2556, dt. 21.03.2018 mbetet në fuqi.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Pas shqyrtimit të ankesës nr. 2756 të datës 28.03.2018 të parashtruar nga Shoqata e Transportuesve të udhëtarëve "Kosova e lirë" dhe Shoqata "Theranda" Suharekë, pas verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi respektivisht paragrafin (4) të nenit 5 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër-urban të udhëtarëve me autobus autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër-urban të udhëtarëve me autobus, duke pas parasysh rrjetin aktual të linjave ndë-urbane si dhe shpalljen e nisjeve të lira nëpër përmes autostradës nr.2556 dt. 21.03.2018, gjegjësisht numrin e nisjeve në regjionin e Prizrenit i cili atakohet nga ankuesit e lartëcekur, vlerëson që nisjet e shpallura nuk pengojnë në nisjet aktuale të lëshuara nga MI-ja në relacionin aktual pasi që kjo është trase e re.

Gjithashtu duke pasur parasysh investimet e shumta që janë bërë në ndërtimin e infrastrukturës rrugore, në këtë kontekst për bartjen e udhëtarëve e cila ndikon në

ngrtitjen e cilësisë së shërbimeve të transportit për udhëtarët dhe ekonomikisht e justifikuar si dhe e favorshme në raport me ofrimin e shërbimeve të transportit rrugor të udhëtarëve që frekuentojnë këtë relacion, duke u mbështetur në paragrafin (4) të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër-urban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus, Ministria e Infrastrukturës e ruan të drejtën e shpalljes apo mos shpalljes së nisjeve të lira. Andaj në rastin konkret, duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve për të pasur linja në këtë relacion për të ofruar cilësi në shërbime të transportit, komoditet si dhe arritje më të shpejt në destinacion, MI ka bërë shpalljen e nisjeve të lira.

Prandaj, në mbështetje të nenit 132, par. 2 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ministri i Infrastrukturës ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet mjet i rregullt juridik. Pala e pakënaqur mund të ngrit konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative.



Iu dergohet:

- Shoqates se Transportuesve të udhëtarëve "Kosova e lirë" "Prizren;
- Shoqates" "Theranda" Suharekë;
- Departamentit te Trasnsportit;
- Arkivit.